

Relacion Teknik




"MBROJTJE LUMORE GJATESORE NGA LUMI OSUM,
FSHATI MBRAKULL, POLICAN

MIRATOI:

KRJETARI I BASHKISE

ADRIATIK ZOTIUKI



I. GJENDJA EGZISTUESE DHE INSPEKTIMI VIZUAL

U krye rikoncijoni i zones se projektit MBROJTJE LUMORE GJATESORE NGA LUMI OSUM,FSHATI MBRAKULL, POLICAN
Pas vleresimit teknik ne terren duke pare humbjen e tokes prej 12 ha prane lagjes Cepan, Mbrakull dhe rrezikimin e tokave dhe serave afer tyre, duke u bazuar ne termat e references qellimi kryesore eshte mbrojtja nga permytja ne kete segment te perafert rreth prej **L= 700 ml**.

Sic e paraqitet gjate inspektimit teknik , bankina e krahut te djathte te lumit eshte e demtuar. Nga inspektimet shikohet qarte qe mbrojtja egzistuese ne nje pjese eshte e amortizuar dhe nga krahu i majte nuk ka mbrojtje.

Bankina dhe skarpatat e lumit jane tejte te demtuar sidomos ndersa ne dy skajet kufitare paraqitet me e mire.

Pjesa me e gerryer ndodhet ne afersi te Stacionit te Pompimit dhe ures kembesore duke rrezikuar gerryerjen e tyre . Vlen per tu theksuar qe ky aks i lumit ka nje gjeresi mesatare 50-80 dhe nje thellesi mesatare 1.5-2.5m por qe varion sipas segmenteve paraqituara me saktesisht ne planine e rilevimit.

Mbrojtja gjatesore ka synim kryesore mbrojtjen e avancimit gerryerjes se tokes ne kete segment .

Zona e projektit eshte kryesisht nga toka bujqesore te cilat jane prane Lumit ne lagjen cepan . Permet te cilat duhen mbrojtur nga gerryerjet



Fig 1 Pamje nga Lumi OSUM, (Mbrakull)

Duke pasur parasysh dhe kushtet e aksit te lumit i cili eshte relativisht i ngushte, ne konceptimin e projektimit duhen marre parasysh ruajtja e rrjedhes natyrale pa ndikuar ne bregun perball ne kete menyre dhe mbrojtja gjatesore te projektohen duke marre parasysh keto faktore.



Fig 2 Segmenti i demtuar i mbrojtjes aktuale te lumit Osum

Ne kete segment sic shikohet dhe nga pamjet me larte mbrojtja egzistuese qe eshte ne nje pjese shume te vogel te lumit thuaje eshte e demtuar teresisht dhe ne pjesen e krahut te djathte te lumit nuk ka mbrojtje. Demtimi i mbrojtjes egzistuese ka sjell si pasoje edhe demtimin e argjinatures pergjatketij krahu dhe si pasoje demtimi i tokave perreth. Kryesisht ne kete pjese te lumit kerkohet nderhyrje e menjehershme , per parandalimine katastrofave me te medha.




Fig 3 Demtimi i argjinatures ekzistuese

II. Rilevimi Zones dhe Topografia

Rilevimi Zones dhe Topografia

Filimisht ndertohet nje relievi me izoipse dhe nje batimetri e thjeshte e lumit ne pjesen e veprave egzistuese te demtuara pergjate lumit. Relievi duhet te perfshi e te brigjet e demtuara te lumit Osum, per te pasur nje ide me te qarte.

Ndersona per zonat ku mendohen te rehabilitohen veprat egzistese apo ndertimi i ri i argjinaturave eshte kryer piketimi me ane te instrumentave GPS CHCNAV

Ne ndihme te procesit te rilevimit ne terren do sherbejne dhe hartat ushtarake 1 :25000, 1:10000.

STUDIMI TOPOGRAFIK DHE PROCEDURAT

Modelimi i terrenit permban te gjitha karakteristikat si ato natyrale ashtu edhe ato te bera nga dora e njeriut brenda zones se rilevuar.

Per te kryer studimin topografik duhet te kryhet nje rilevim topografik i kesaj zone (i relievit dhe kuotave te terrenit)

Per kryerjen e rilevimit topografik, **ESHTE PERDORUR** pajisja GPS CHCNAV, ne pronesi te dhenat e te cilit perftohen ne kohe reale dhe zhvillohen lehtesisht ne kompjuter, ne baze te modelimit topografik te terrenit.

Për matjen e pikave te rjetit dhe te pikave detaje është përdorur metoda kinematike në kohë reale, (RTK), e cila parashikon përdorimin e marrësve me dy frekuenca, të lidhur midis tyre me radio dhe me regjistruet të dhënash të paisur me programe të posacme.Marrësi referues, që vendoset në një stacion të njohur, i transmeton pozicionin e vet dhe të dhënat satelitore marrësit lëvizës, i cili në bazë të të gjitha informacioneve të mbledhura, llogarit në kohë reale pozicionin e vet në lidhje me stacionin referues. Metoda RTK karakterizohet nga matje të vazhdueshme fazore, që korrigjohen në kohë reale dhe realizohet me anën e teknikës, që përbëhet nga jo më pak se dy marrësa GPS, nga jo më pak se dy radiomodeme dhe paisja e kontrollit për operimin me marrës GPS.Kjo teknikë siguron. një saktësi shumë të lartë, pasi paisja e përdorur është GPS (GPS diferencial me dy frekuenca).

Duke pasur parasysh qe pikat detaje jane matur duke perdorur teknologjine GPS Trimble Glonass me metoden (RTK).kjo siguron nje saktesi prej 10 mm + ppm ne nje reze veprimi prej 1-2.5 km, atehere dadim ne konkuzionin saktesia eshte mjaft e mire per qellimin e ketij projekti. Përdorimin e metodës kinematike ne kohe reale (RTK) ne matjet satelitore qe jep saktesi te rendit (2cm + 1cm/km)



III. MASAT QE MEREN TIPI I MBROJTJES DHE PERCAKTIMPROJEKTI

Sipas ketij projekti, "MBROJTJE LUMORE GJATESORE NGA LUMI OSUM,


FSHATI MBRAKULL, POLICAN sipas aksit te propozuar egistues eshte te paraqitur ne Planimetrine bashkangjitur ne shkallen 1:500,

Konsiston ne ndertimin e mbrotjes gjatesore me gjeresine e kurores me lartesi te ndryshme sipas terrenit

PROFIL TERTHOR I MBROJTJES

MBROJTJA 1 (PIK 0+200.0 DERI PIK 0+457.2)

MBROJTJA 2 (PIK 0 DERI PIK 0+208)



PROFIL TERTHOR I MBROJTJES

MBROJTJA 1 (PIK 0 DERI PIK 0+200.0)




Fig 5. Pamje skematike e Mbrojtjes

Argjinatura ne kete segment ka nje gjatesi prej L=657 ml e Argjinatures per rehabilitim. Persa perket kuotave te Argjinatures eshte konsideruar perlogaritja hidraulike duke mare prurja me 1% siguri Q=1200 m³/sek.



Nisur nga kushtet konkrete ne te cilen ndodhet kjo veper, u kryen te gjitha punimet enevojshme topografike dhe llogaritjet Hidrologjike per ndertimin e saj.



KONSULENTI REKOMANDON VARIANTIN ME MBROTJEN EKOMBINUAR GJATESORE .

Kostoja e punimeve e pasqyruar ne preventivin perfundimtar te projektzbatimit do te jete e perafert mer shumen **70,886,157 leke** me Tvsh.

ARENA MK shpk
Ing.Natasha MYRTAJ

